



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
GJILAN
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" UNIVERSITY
PRIZREN
Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren
www.uni-prizren.com tel: 0 29- 232 140



UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" UNIVERSITY
PEJE
UÇK pa nr., 30000, Pejë, Kosovë
www.unhz.eu tel: 039421739

27/10/2017
Nr. 01-247

Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan në bashkëpunim me Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren dhe Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë, morën vendim për shpalljen e:

KONKURSIT PLOTËSUES

Për studime Master në programin Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME STUDIMET MASTER

1. Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan në bashkëpunim me Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren dhe Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë, për vitin akademik 2017/2018 do të regjistrojnë 50 studentë të rregullt sipas kuotave të përcaktuara.
2. Në studimet master mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet baçelor nga fusha Juridike, Ekonomike, Administrative, Shkencave Politike dhe nga ndonjë fushë e afërt me këto, apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës nga këto fusha të studimit në të gjitha institucionet e akredituara të arsimit të lartë të Kosovës.
3. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë studentët të cilët kanë mbaruar studimet themelore në Universitetet partnere.
4. Të drejtë konkurrimi kanë edhe ata të cilët studimet themelore i kanë përfunduar jashtë Kosovës. Në raste të tilla kandidati/ja duhet të sjellë vendimin mbi nostrifikimin e diplomës, e cila lëshohet nga MASHT-i.

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- a) Ekstraktin e lindjes (origjinal);
- b) Diplomën origjinale ose certifikatën e diplomimit të studimeve themelore;
- d) Kopjen e letërnjoftimit;
- e) Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. (vendimi bëhet në MASHT);
- f) Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti (Pagesën prej 2.5 euro, forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb faqja e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, ndërsa pagesa bëhet në bankë).

AFATI I KONKURSIT

Paraqitja e dokumenteve zgjatë nga data 28.10.2017 deri më datë 03.11.2017.

Aplikimi on-line bëhet përmes butonit APLIKO ONLINE në ueb-faqen zyrtare të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan ose në linkun:

<http://185.67.178.39/AplikimionlineMaster.aspx>

Pas aplikimit online kandidatët dorëzojnë dokumentacionit në zyrat e shërbimit të studentëve në universitetet përkatëse (Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan, Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren dhe Universitetin “Haxhi Zeka” Pejë).

Në të tri universitetet partnere (Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan, Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren dhe Universitetin “Haxhi Zeka” Pejë) dokumentet pranohen në administratën e Fakultetit Juridik (zyrën për çështje të studentëve) çdo ditë përveç ditës së diel nga ora 09:00-15:00.

Provimi Pranues:

1. Provimi pranues mbahet me dt. 07.11.2017 prej orës 10:00 në objektet e fakulteteve juridike të universiteteve partnere të programit.
2. Listat e aplikantëve do të shpallen në faqet zyrtare të tri universiteteve më: 04.11.2017.
3. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues kandidatët nuk mund të kenë pranë vetes telefona celularë dhe asnjë mjet tjetër teknologjik.
4. Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri më 08.11.2017, në universitetet përkatëse, si dhe në uebfaqet e universiteteve partnere.
5. Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri më 10.11.2017
6. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të degës përkatëse të fakultetit dhe atë: **E Drejta Administrative, Qeverisja Lokale dhe e Drejta Kushtetuese.**

MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve është 100 pikë, dhe atë:

- Suksesi në studimet themelore deri në 50 pikë;
- Suksesi në provimin pranues deri në 50 pikë;
- Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40 % nga numri i pikëve të parapara për provim pranues;

E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve.
2. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave të Universiteteve partnere më datë 10.11.2017 duke filluar nga ora 10:00.